



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.15

Prishtinë, më 27.05.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyqi, Teuta Haxhiu, Mufera Sinik, Serdjan Popovic.

Pjesëmarrës të tjerë: Blendina Krasniqi- UNDP (praktikante), Arben Hajrullahu-UP/CPC, Alban Haliti-CPC, Lirika Demiri-CPC, Lirije Palushi-CPC, Petrit Hysaj-OSBE.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 22.05.2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.05.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 22.05.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Nait Hasani, tha se projektligji për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u është shpërndarë deputetëve, ka disa vërejtje që kanë të bëjnë me disa nene, nenin 1, 8 dhe nenin 10, pajtohet për miratim në parim ndërsa ne procedurat e mëtejme mund të bëhen plotësime dhe ndryshime.

Shpejtim Bulliqi, lidhur me këtë projektligj tha se ka hapësirë për përmirësim, kur flitet për kriteret për tu bërë anëtarë i Akademisë, çështja e moshës dhe çështje tjera që duhet ti diskutojmë gjatë fazës së shqyrtimit. Në parim e përkrahu dhe theksoi se gjatë shqyrtimit në Komision do ta jap kontributin e tij.

Bekim Haxhiu, tha se projektligji për Akademinë e Shkencave dhe Arteve është i mangët si për nga përbërja edhe nga procedimi i çështjeve, ai theksoi se duhet ndryshuar qasja në Akademi në mënyrë që ajo të jetë inovative për vendin dhe të jetë konkurrense me Akademitë e Shkencave në rajon dhe më gjerë, duhet të precizohen saktë kriteret, ndërsa Statuti i Akademisë së Shkencave duhet të shqyrtohet dhe miratohet në Kuvendin e Kosovës.

Teuta Haxhiu, tha se e përkrah në parim projektligjin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve, përkundër kritikave shpresoj që me organizimin e dëgjimit publik të kemi një ligj që është në interes për Akademinë dhe vendin. Sa i përket provimit të maturës tha se në grupet punuese do ti jap sygjerimet e mia, ndërsa Raportin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë tha se nuk e përkrah, ka shumë vërejtje dhe do të kërkoj që ky raport mos të votohet në Kuvend. Sa i përket anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë kërkoj që i njëjti të riprocedohet për votim në Kuvend.

Shukrije Bytyqi, lidhur me projektligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve, tha se e përkrah në parim përkundër disa gabimeve teknike, duhet të jemi të kujdesshëm te kriteret për pranimin e anëtarëve dhe te marrim informata të tjera edhe prej Akademisë së Shkencave edhe prej akterëve të tjerë të përfshirë në këtë lëmi.

Srdjan Popovic, tha se e përkrah në parim projektligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, do ta jep kontributin e tij gjatë shqyrtimit të mëtejme pas leximit të parë.

Ismajl Kurteshi, tha se e përkrah në parim projektligjin dhe pajtohet me propozimet paraprahe, lidhur me Statutin dhe për propozime konkrete do të merremi pas leximit të parë në Kuvend.

Mufera Sinik, e përkrah në parim këtë projektligj dhe në fazën e amendamentimit do ta jap kontributin e saj.

Pas diskutimeve Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr.05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim, Projektligji Nr.05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore

Nait Hasani, tha se interesimi për pjesëmarrje në dëgjimin publik të organizuar për këtë Projektligj ka qenë shumë i vogël për shkak të shtyrjes së miratimit por ne kemi marrë vërejtjet me shkrim dhe do ta shqyrtojmë më tutje këtë projektligj. Në vazhdim ai propozoi që të organizohen dëgjime publike edhe në qytete tjera pas përfundimit të testit të maturës.

Shukrije Bytyqi, tha se është e nevojshme që të paktën edhe në dy regjione të mbahen dëgjime publike, pas afatit të parë të testit të maturës.

Ismajl Kurteshi, tha se duhet që edhe në dy apo tre regjione të organizojmë dëgjime publike sepse do të përfitonim shumë.

Shpejtim Bulliqi, tha se pasi që ka kohë të mjaftueshme është mirë të organizohen edhe forma të tjera të diskutimit publik sepse ka nevojë për plotësime dhe nga dëgjimi publik i më parshëm kemi marrë sygjerime të cilat mund të inkorporohen në projektligj.

Bekim Haxhiu, tha se ne si Komision duhet të punojmë në takimet e radhës me Ministrinë dhe me grupet e interes dhe duhet të angazhohemi gradualisht në këtë ligj që ta përfundojmë para pushimit të Kuvendit.

Nait Hasani, përcaktoi Ismajl Kurteshin si përgjegjës për organizimin e dëgjimit publik në Gjilan, Bekim Haxhiu-n në Mitrovicë, Salih Morina në Prizren dhe Gjakovë, Shpejtim Bulliqi në Prishtinë dhe përcaktoi datat 8, 9 dhe 10 qershor për mbajtjen e këtyre dëgjimeve.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Nait Hasani, tha se në raportin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore përshkruhet puna dhe angazhimi i Këshillit por ky raport është vetëm njoftues sepse ka një kërkesë nga administrata e Kuvendit për pranim të raporteve vjetore të të gjitha institucioneve të pavarura dhe pasi të formohet bordi i Këshillit do të japim një vendim për seancë.

Bekim Haxhiu, tha se nuk kemi pse të diskutojmë raportin përderisa nuk është koha për ta aprovuar apo për ta refuzuar. Ai kërkoi që ti drejtohet një shkresë kryesisë së Kuvendit për tu shpallur konkursi i ri për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturore sipas ligjit.

Ismajl Kurteshi, tha se duhet të diskutojmë dhe të shqyrtojmë raportin e Këshillit pastaj në bazë të bindjeve që i ka secili anëtarë ta pranoj apo ta refuzoj.

Shpejtim Bulliqi, tha se ky raport po del të jetë i individëve të caktuar dhe jo i këtij Këshilli prandaj nuk e di pse duhet ta shqyrtojmë. Ai theksoi se nuk pajtohem që të shpallet konkursi përsëri për zgjedhjen e bordit të Këshillit për Trashëgimi sepse bordi është zgjedhur por duhet të kërkojmë nga kryesia që ajo pikë të futet përsëri në rend të ditës në seancë.

Shukrije Bytyqi, tha se raporti që ka ardhur nga Këshilli e kam analizuar dhe nuk i plotëson kushtet. Në vazhdim tha se e dimë që prej vitit 2010 ky Këshilli nuk ka qenë i kompletuar dhe ne e kemi bërë një punë të mirë me zgjedhjen e anëtarëve prandaj duhet të hyn në votim ata anëtarë që i kemi zgjedhur.

Muferra Sinik, tha se ky raport nuk i plotëson kushtet për tu shqyrtuar dhe sa i përket Këshillit për Trashëgimin Kulturore, tha se i kemi zgjedhur në mënyrë të drejtë prandaj duhet si Komision të kërkojmë që kjo pikë të hy në rend të ditës.

Nait Hasani, tha se në emër të Komisionit do të kërkoj që të kthehet edhe një herë në votim ky Këshill, ndërsa sa i përket raportit ne e pranojmë por nuk do ta shqyrtojmë.

Ismajl Kurteshi, kërkoj që raporti të shqyrtohet dhe Komisioni të del me një përfundim nëse e pranon apo e refuzon raportin sepse shkresa e ardhur nga administrata e Kuvendit nuk ka asnjë bazë ligjore.

Fehmi Pireva, tha se kemi pasur probleme me raportet prej vitit të kaluar pasi që kemi mos kompletim të shumë Agjencioneve të pavarura dhe mëçenëse nuk kemi një lloj standardizimi rreth obligimeve të raportimit, kemi bërë përpjekje që të ofrojmë një shërbim profesional dhe të respektohen praktikat e kaluara dhe mbi bazën e kësaj praktike i'u kemi referuar edhe kësaj çështje për të cilën po diskutohet.

Nait Hasani, për shkak të mungesës së nënkryetarit këtë pikë e shtyn për mbledhjen e ardhshme.

6. Të ndryshme

Ismajl Kurteshi, kërkoi që në mbledhjen e ardhshme Komisioni ta parasheh një pikë të rendit të ditës që të shqyrtohet plani i veprimtimit për monitorimin e Ligjit për arsimin parauniversitar.

Nait Hasani, tha se një hulumtim shkencor në shkencat shoqërore në Kosovë që e ka bërë organizata CPC kanë kërkuar ta prezantojnë këtu.

Arben Hajrullahu, tha se ne do të mundohemi të jemi sa më të shkurtër dhe të ju njoftojmë për aktivitetet që janë zhvilluar dhe për rrjedhshmërinë e këtyre raporteve.

Alban Haliti, tha se politikat strategjike, programet dhe ligjet të cilat lidhen me funksionimin e arsimit të lartë në Kosovë dhe në veçanti me hulumtimin shkencor nuk janë në nivelin e duhur dhe procesi i dialogimit të atyre që bëjnë politika nuk ka qenë i mirëfillt në kuptim të bashkëpunimit me pjesën e botës Akademike. Ai tha se prej vitit 2012 organizata ka iniciuar një proces të dialogimit me politik bërës me qëllim që të fuqizohen shkencat sociale në Kosovë dhe janë organizuar shumë aktivitete ku janë prezantuar studime, analiza që e përshkruajn gjendjen në arsimin e lartë në Kosovë dhe orientimin në shkenca sociale.

Arben Hajrullahu, tha se jemi fokusuar në çështjet e arsimit të lartë dhe në kapacitetet e hulumtimeve kryesisht në shkencat shoqërore. Ai tha se qëllimi ynë është që çdo vendim që merr Komisioni ta merr bazuar në informata më të detajuara. Në vazhdim tha se shpresoj që ligji për arsimin e lartë, të krijoj kornizën ligjore të arsyeshme për veprimtarin e Universitetit dhe bartësve privat të arsimit të lartë dhe do të ishte shumë e nevojshme që të krijohen parakushte për një udhëheqje dhe menaxhim efikas të arsimit të lartë.

Shpejtim Bulliqi, tha se është mirë që e keni bërë këtë hulumtim dhe përgëzoj për angazhimin. Sa i përket hulumtimeve shkencore tha se ka probleme dhe pengesa jo vetëm në shkencat sociale por në përgjithësi në të gjitha shkencat sidomos në shkencat ekzakste.

Nait Hasani, tha se do të mundohemi të krijojmë një strategji afatgjate për arsimin e lartë. Ai theksoi se jemi të gatshëm për bashkëpunim dhe kur të procedohet projektligji për Arsimin e Lartë kërkojmë të jeni pjesë e debateve të organizuara nga Komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani